



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 82/2 Prot.

Tiranë, më 11.01.2019

**VENDIM**

Nr. 1, datë 11.01.2019


**MBI MIRATIMIN E OBJEKTIVAVE PËR VITIN 2019,  
NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 49, të Ligjit Nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH", dhe në Vendimin e Senatit nr. 1 datë 10.01.2019 "Mbi miratimin e objektivave për vitin 2019", Bordi i Administrimit, në mbledhjen e tij të datës 11.01.2019,

**VENDOSI :**

- 1.Të miratojë Objektivat për vitin 2019, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas tabelave bashkangjitur.
- 2.Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Rektorati, Njësitë kryesore, Drejtoritë dhe Degët në administratën e Universitetit të Sporteve të Tiranës.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

  
Vladimir Gjonaj



## Deklarata e Misionit të Universitetit të Sporteve të Tiranës

Objektivat e Universitetit të Sporteve të Tiranës për vitin 2019

<b>Qëllimi</b>	<i>Përmirësimi cilësor i mësimdhënies dhe përvetësimit të dijeve në UST përmes: përmirësimit të curriculave në të tre ciklet e studimit sipas kërkesave të Ligjit të Arsimit të Lartë , përmirësimi i metodave të mësimdhënies nëpërmjet zhvillimit të burimeve njerëzore, ndërthurje e mësimdhënies me kërkimin shkencor, sigurimi i cilësisë në UST. Rritja e pranimeve.</i>	
<b>Nr</b>	<b>Treguesit të Performancës/Produktit për vitin 2019</b>	
1.1	<i>Zhvillimi institucional, organizimi e menaxhimi i universitetit</i>	
1.1.1	Përmirësimi i mekanizmave të qeverisjes në UST, veprimtaria institucionale në të gjitha strukturat dhe njësitë përbërëse, transparencë në drejtim dhe llogaridhënie sistematike.	
1.1.2	Fuqizimi dhe funksionimi efikas i sigurimit të cilësisë së brendshme, organizimi institucional i njësive të sigurimit të cilësisë së brendshme, forcim i veprimtarsë së tyre.	
1.1.3	Konsolidimi, rritja, zgjerimi i UST-së në të gjitha aspektet për t'ju përgjigjur zhvillimeve ekonomike e sociale dhe kërkesave të tregut të punës; Studimi i tregut, përtëritja e këtij studimi për tu orientuar drejt për llojet e masterave profesionale që do të hapen.	
	1. Të rishikohet baza ligjore, aktet nënligjore, rregulloret e ndryshme për funksionimin e strukturave, për drejtimin e strukturave brenda UST. 2. Ngritja e grupeve të punës për përgatitjen e dokumentacionit për rregulloret e njësive kryesore dhe të departamenteve, të programeve të studimit 3. Organizim trajnimesh të ndryshme për mirëfunksionimin e cilësisë së drejtimit, raportime të kërkuara në linjë hirarkike.	
	Vazhdimi i punës i Njësies së Sigurimit të Cilësisë së Brendshme dhe dorëzimi i raporteve të punës së saj.	
	Studimi i tregut të punës dhe i kërkesave të tij , nga IKSHS, ngritja e një fakulteti të ri në fushën e shkencave të rehabilitimit si nevojë e tregut, hapja e MP manaxhim në sport e turizëm, riorganizimi i MP të ciklit të dytë si mësuës të edukimit fizik dhe edukim shëndetësor.	


1.1.4	<p>Ngritja e nivelit të studentëve që do të pranohen në UST, bazuar në treguesit e notave, koeficientët lëndorë apo të llojit të shkollës, si dhe të testeve të konkurimit praktik që ofrojnë treguesit më të plotë të zhvillimeve fizike e lëvizore të kandidatëve konkurrentë, të përfshirjes së sportistëve, rritje të diversitetit në pranimin e studentëve nga të gjitha qytetet e vendit, e të gjinisë, nga trojet dhe nga vende të ndryshme të botës;</p>	<p>Studim mbi çështjet e testeve, të treguesve dhe rezultateve të konkursit (dy njësitë kryesore FSHL, FVFR). Rishikim i testeve dhe rregulloreve për pranimet e reja, dita e informimit të maturanëve; përcaktimi i stafit akademik që do të angazhohet për informimin e maturanëve që të aplikojnë për tu pranuar në FSHL dhe FVFR.</p>
1.1.5	<p>Krijimi i lidhjeve dhe bashkëpunimeve me institucione homologe të vendit dhe të huaja; (me vendet e ballkanit dhe ato europiane).</p>	<p>Marrëveshje funksionimi dhe rivitalizim i tyre. Rritja e bashkëpunimit të UST -së me institucionet homologe shkëmbime përvoja me pedagogë të huaj për leksione seminarë, simpoziume shkencore e akademike, veprimtari të përbashkëta kërkimore shkencore (staf akademik).</p>
1.1.6	<p>Bashkëpunim i qëndrueshëm me organizmat dhe institucionet sportive të vendit. Bashkëpunim i qëndrueshëm, nëpërmjet lidhjeve të marrëveshjeve, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe institucione, apo mjedise të ndryshme sportive e rehabilituese, për zhvillimin e praktikave mësimore.</p>	<p>Bashkëpunimin me KOKSH, Federatat e ndryshme sportive, Bashkinë Tiranë (APR), për shërbim ndaj studentëve dhe mbështetje në realizimin e programet e studimit. Marrëveshje me Drejtorinë Arsimore dhe Qendra fitnesi e rehabilitimi për praktikat mësimore.</p>
1.1.7	<p>Rritja e të ardhurave, sipas të gjitha mundësive ligjore, nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha kapaciteteve njerëzore e mjediseve. Çdo njësi kryesore, administrata, do të jenë krijuar për të gjetur hapësira e mundësi që të gjenerojnë të ardhura për universitetin. Rritja e të ardhurave nga projektet dhe format e tjera të kërkimit shkencor.</p>	<p>Rishikim i tarifave të shkollimit për vitet në vazhdim, rishikim i tarifave të shërbimeve me të tretë dhe shtim i tyre duke ju përshtatur kërkesave të tregut. Aplikim në projekte në organizma të huaj, dhe brenda vendit për financime në projekte kërkimore shkencore.</p>
1.1.8	<p>Mbështetje institucionale për sportistët e nivelit të lartë dhe lëvizjet sportive të organizuara të studentëve.</p>	<p>Parashikim në aktet nënligjore dhe në rregulloret e funksionimit të UST-së të krijimit të lehtësirave të tyre në ndjekjen e studimeve, mbështetje për aktivitetet e studentëve si brenda dhe jashtë shtetit.</p>
1.1.9	<p>Lidhje me tregun e punës për të orjentuuar drejt studentët në karrierën e tyre duke synuar hartimin e një databaze të punësimit të ish studentëve tanë në vite.</p>	<p>Në vazhdim për ndërtimin dhe funksionimin e Qëndres së Karrierës dhe trajnimi për platformën ALUMNI.</p>


1.1.10	Përfshirja e profesionit të trajnerit tek profesionet e rregulluara me ligj.	Ndjekja e procedurave në institucionin qëndror për aktet nënligjore MASR-FVFR.
1.1.11	Ndjekja dhe përfundimi i hipotekimit të pronave të universitetit.	Ndjekja e procedurave në MASR për aktet nënligjore për hipotekimin e pronave (lista e të gjitha objekteve me sipërfaqet përkatëse).
1.1.12	Hartimi i një sistemi të plotë të evidencave me indikatorë të rëndësishëm të institucionit.	Përcaktim i modeleve të njësuar brenda UST-së dhe raportimi sipas hierarkisë institucionale.
1.1.13	Dixhitalizimi i bibliotekës, dokumentacionit financiar, arkivës.	Vazhdimi i procedurave për përfundimin e projekteve për realizimin e tyre, duke patur parasysh krijimin e fondeve nga të ardhurat.
2.1	<i>Mësimdhënia dhe të nxënësit</i>	
2.1.1	Formimi shkencor, profesional i studentëve për tu përgatitur si specialistë të lartë dhe të aftësohen të zhvillojnë punë të kualifikuara, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit.	Organizimi i workshop-eve, seminareve dhe aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në konferenca të ndryshme deri në nivel departamenti, për të tre njësitë kryesore(FSHL,FVFR, IKSHS) për stafin akademik, kërkues në bashkëpunim dhe me studentët .
2.1.2	Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies e përvetësimit të dijes; Modernizimi i metodave të mësimdhënies.	Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme mësimore kërkimore shkencore. Fuqizimi i formimit dhe aftësimit praktik të studentëve të lëndëve sportive, përdorimi i bazës materiale, bazuar në njohuri shkencore dhe didaktike metodike. Vendosja në funksionim e mjeteve elektronike dhe paisjeve profesionale. Përdorimi i metodave ndërvepruese të përqendruara tek studentet, duke u bazuar në diskutime, në zhvillimin e ideve, për të nxitur aftësimin tërësor .
3.1	<i>Kurrikula</i>	

3.1.1	Rishikim i kurrikulave mbështetur në kërkesat të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL ne RSH", dhe akteve nënligjore, të kërkesave të HEAL, dhe përmirësim i përmbajtjes së tyre.	Rishikim i literaturës në programet e studimit për orientim për studentët. Përfundimi i procedurave për miratimin e modelit të diplomës MP i riorganizuar "Mësuesi në edukimin fizik dhe shëndetësor në arsimin parauniversitar" në FSHL dhe përgatitja për dhënie e studentëve. Rishikimi i Planit mësimor të ciklit të dytë të studimit "Master Shkencor" në FSHL. Rishikim dhe përshtatja e lëndëve sipas semestrave do të jetë në fokusin e punës së FVFR)
4.1	<b>Infrastruktura, burimet financiare, sistemi i informacionit</b>	Përmirësim i Rregulloreve të funksionimit të infrastrukturës në shërbim të procesit mësimor dhe vendosja e një kalendari për funksionimin e tyre (paradite dhe pasdite për të dy ciklet e studimit për FSHL e FVFR). Mbulimi i fushës së minifutbollit.
4.1.1	Shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve të godinave, auditorëve, kabineteve, laboratorëve, palestrave, terreneve sportive, nëpërmjet një menaxhimi e shfrytëzimi efikas në nivel universiteti.	Vënia në funksionim total e godinës së re dhe sistemimi dhe rikonstruksioni i godinave të vjetra, zbatimi i projektit të pistës dhe stadiumit, përgatitja e dokumentacionit për lejen e ndërtimit për godinën e gjimnastikës. Mbikqyrja e funksionimit të ambjenteve mësimore, kontroll i stafit mbikqyrës të tyre si dhe planifikimi në kohë i mjediseve mësimore për fakultetin e tretë nëse aprovohet hapja për vitin akademik 2019-2020. Rikonstruksioni i AULA - FSHL, Sistem Audio - FSHL, Sistem Audio - FVFR, Salla e Konferencave.
4.1.2	Krijta e sipërfaqeve për përdorim, nëpërmjet një risistemimi të të gjithë hapësirave të klasave, duke shfrytëzuar çdo mundësi ekzistuese të hapësirës së UST-së. Investime të fuqishme në ndërtimin e mjediseve e terreneve sportive të nivelit bashkëkohor. Krijta e nivelit të mirëmbajtjes të sallave të leksioneve, të kabineteve, klasave, të laboratorëve dhe i fasiliteteve teknike.	Blejje mjjetesh mësimore dhe pajisje për palestrat.
4.1.3	Shtimi dhe rifreskimi i pajisjeve dhe mjeteve didaktike të palestrave, si dhe mjeteve të tjera didaktike.	Nxjerrja e të dhënave nga fakultetet për pjesën mësimore për të gjithë programet e studimit dhe llogaritja e kostos në terma financiare në bashkëpunim me administratën.
4.1.4	Përcaktimi i kostos reale për çdo program studimi.	Përpunimi i të dhënave nga njësitë kryesore sipas një modeli standard çdo 3 mujor.
4.1.5	Përpunimi dhe funksionimi i një sistemi të plotë e të saktë informacioni.	

5.1	<i>Personeli akademik</i>	
5.1.1	Rritja e nivelit shkencor e mësimdhënës i stafit pedagogjik, promovimi i tij drejt titujve akademikë; b) Fitimi i gradës shkencore “Doktor”, për pedagogët me master shkencor.	Pjesëmarrje të ndryshme në konferenca dhe botime shkencore, kërkesë për miratimin e ciklit të tretë të studimeve, për të patur përparësi stafi akademik ekzistues.
5.1.2	Programimi i ngarkesës së punës së personelit, i ngarkesës mësimore në ciklet e studimit sipas kualifikimit akademik, i veprimtarisë shkencore, si dhe i punës e kontributit të tyre në ndihmë të institucionit. Matje e treguesve të performancës së personelit, zhvillimi i një analize dhe llogaridhënie të veprimtarisë së personelit akademik, duke filluar nga njësia bazë, me analiza të detajuara e konkrete, deri tek analizat në nivelet e asamblesë së personelit.	Përgatitja sipas një tablele të standartizuar për të dy njësitë kryesore të ngarkesës mësimore në ndihmë të institucionit dhe kërkimit shkencor. Vlerësimi i punës së stafit akademik në fund të vitit akademik sipas treguesve të performancës.
5.1.3	Punësimi i stafit akademik, punonjësve administrativ si dhe kërkuesve shkencor të rinj, duke synuar një kontigjent cilësor të të shkolluarve dhe të të kualifikuarve brënda dhe jashtë vendit, të cilët demonstrojnë potencial të shkëlqyer.	Propozim i kriterëve dhe nevojave nga njësitë kryesore dhe Administratori për shpalljen e procedurave të konkursit sipas legjislacionit në fuqi.
6.1	<i>Kërkimi shkencor</i>	
6.1.1	Zhvillimi i veprimtarisë kërkimore shkencore, integrimi i mësimdhënies me kërkimin shkencor dhe formimi i shkencëtarëve të rinj në fushat që mbulon. Bashkëpunim ndërmjet njësite kryesore, pedagogëve brenda institucionit, i planifikuar e mbi baza shkencore e organizative për kërkimin shkencor në UST.	Planifikimi i punës kërkimore shkencore në fillim të çdo viti akademik dhe analiza e punës së kryer. Përdorimi i mekanizmave të brendshëm për të siguruar bashkëpunim të nevojshëm duke krijuar praktika më të mira.
6.1.2	Fuqizimi i laboratorëve dhe shfrytëzimi efektiv i tyre.	Shfrytëzimi i laboratorëve për procesin mësimor dhe për kërkimin shkencor sipas një rregulloreje të caktuar dhe kualifikimi i thelluar i personelit përgjegjës në laborator dhe kolaudimi i pajisjeve.
6.1.3	Organizimi i rregullt e periodik i simpoziumeve shkencore, konferencave shkencore mbi bazën e kriterëve e standardeve shkencore ndërkombëtare;	Rritja e numrit të simpoziumeve shkencore, konferencave të kërkimit shkencor jo vetëm në nivel UST-je, por dhe njësite kryesore.

6.1.4	IKSHS do hartojë projekte kërkimore shkencore, do realizojë ekspertiza e veprimtari mbështetëse që krahas vlerave shkencore të gjenerojë të ardhura për UST-në.	Standardizimi dhe licensimi i laboratorëve që mund të përdoren për të krijuar të ardhura për institucionin dhe realizimi i studimeve që mund ti shiten tregut.
6.1.5	Botimi i teksteve universitare për studentët. Botimi i revistave shkencore, materiale studimore e shkencore dhe revista promovionale FOKUS.	Procedura e miratimit të teksteve universitare, dhe prokurimi për botimin apo ribotimi tyre, revistës FOKUS dhe JPAS.
7.1	<i>Studentët dhe mbështetja ndaj tyre</i>	
7.1.1	Mbështetje dhe ndihma ndaj studentëve të të gjitha cikleve të studimit për informim, orientim, si dhe për punësim e karrierën e tyre. Gjurmimi i studentëve që përfundojnë studimet.	Ngritja dhe funksionimi i organizmave studentore. Funksionimi i Zyrës së Karrierës për studentët pranë Fakulteteve. Platforma Alumni trajnimi i vazhdueshëm i stafit.
7.1.2	Politikë mbështetëse për studentët që zhvillojnë veprimtari sportive të nivelit të lartë në sportin tonë.	Parashikimi në rregullore i lehtësirave për mbështetjen për studentët elitari, që ndjekin shkollën dhe sportin, përdorimin e ambjentëve jashtë procesit mësimor dhe lehtësira të tjera.
7.1.3	Mbështetje për këshillat e studentëve dhe financim i veprimtarinë e tyre.	Parashikimi i fondeve për mbështetjen financiare, Hartimi i një guide për studentët çdo vit akademik. Përmirësimi i kushteve të studimit, mbështetjen e aktivitetëve të ndryshme sportive dhe sociale që gjallërojnë jetën e tyre në universitet. Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shtetit, lënia dhe funksionimi i ambjentëve pasdite pa pagesë në një orar të dakortësuar.

Kryetari i Bordit të Administrimit  
  
 Vladimiro Gjoni

Kryetari i Senatit  
  
 Prof. Dr. Agron CUKA

